# DËSHMI ARKIVI

**A-459778**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "U nxor jashtë kontekstit" - Biblioteka e Lushnjës përgënjeshtron deputetin e PD: Poezia për Enver Hoxhën ishte rrëfim nga diktatura, jo glorifikim |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/u-nxor-jashte-kontekstit-biblioteka-e-lushnjes-pergenjeshtron-korreshin-i587247` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 20 shtator 2026, 11:32:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 20 shtator 2026, 11:30:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1a13884f3c0078e15781bd4e1fb8a42c36470f41db4011a0e12ef4cb40f5a222` |
| TEKSTI | `0ea17b6292c81bc31896afa1bd7c6108038df54f6efc0df8871a4583969a4d5c` |
| PAMJA | `dacb7c7ffad3fed920508abce4d6e0787e56816f648422d97717fdb5d20715eb` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5867fb4ed88956b5c8d7bd2fddddca25b3e0eda9f781ca52a9e0db0f3a6bce1f` |
| E MËPARSHMJA | `20bf8c33d6abd9cff2ffa84aa1ec987773cd56006524e64902fc58ddee2e2dae` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5867fb4ed88956b5c8d7bd2fddddca25b3e0eda9f781ca52a9e0db0f3a6bce1f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# "U nxor jashtë kontekstit" - Biblioteka e Lushnjës përgënjeshtron deputetin e PD: Poezia për Enver Hoxhën ishte rrëfim nga diktatura, jo glorifikim

TemA

20 Shtator 2026, 13:30Politika TEMA



Biblioteka e Lushnjës ka përgënjeshtruar lajmin e publikuar nga deputeti demokrat Saimir Korreshi, duke deklaruar se pamjet nga aktiviteti janë interpretuar jashtë kontekstit.

Në materialin e publikuar, pedagogia tregon një episod nga fëmijëria e saj, në periudhën kur vdiq diktatori Enver Hoxha. Ajo tregon se ishte nxënëse e shkëlqyer dhe se, pavarësisht biografisë së keqe familjare, prezantonte dhe recitonte poezi në aktivitetet e shkollës.

Sipas rrëfimit të saj, pas vdekjes së diktatorit ajo duhej të recitonte një poezi. Babai i saj, i cili kishte pasur babanë të vrarë nga diktatura, e ndihmoi në përgatitjen e poezisë.

Ajo shpjegon se e kishte mësuar poezinë përmendësh dhe se kishte frikë se një paraqitje e keqe mund të sillte pasoja për babain e saj, përfshirë rrezikun e burgosjes.

*"Kur isha në 8-vjeçare, vdiq diktatori. Unë isha nxënësja më e mirë, megjithëse isha me biografi të keqe. I prezantoja, dilja para shkollës për të thënë poezi të bukura, falë babit që më ndihmonte në letërsi. Vdiq diktatori dhe duhet të isha më e mira në poezi të bukur. Babi që kishte babanë të vrarë nga diktatori duhet të më ndihmonte, vetë nuk ia dilja dot.*

*Bëri një poezi që unë isha e tmerruar, duhet ta thoja mësoja shumë mirë përmendësh, se mund të merrja figurë të keqe dhe mund ta fusnin në burg babin. Unë duhet të isha ajo që duhet të shkëlqente. E mbaj mend edhe sot këtë poezi, po të doni mund t'ua them. Kuptoni metaforat dhe forcat e mendimit"*, deklaroi ajo.

Deputeti demokrat Saimir Korreshi raportoi më parë se në këtë ngjarje të administruar nga Bashkia është duartrokitur dhe është kënduar për diktatorin, me vargjet: "Për Enverin yll e dritë… Qajnë pleqtë qajnë të rinjtë". E gjithë kjo ngjarje, mësohet se është zhvilluar në prani të kryetares së Bashkisë, Eriselda Sefa, e cila ka marrë edhe fjalën.

---

Lini një Përgjigje

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

“Paketa e Maleve” për agroturizmin, Rama sqaron çfarë përfitojnë familjet

12:00 Politika / 3 komente

[Videoja e prerë: si Saimir Koreshi manipuloi rrëfimin e Flora Ngucajt për ta kthyer në "propagandë komuniste"]

11:20 Politika / 21 komente

[Rama propozon partneritet me komunitetet turistike për mbrojtjen e natyrës: Do krijojmë edhe një fond mbështetës]

11:00 Politika / 13 komente

[Komiteti i Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri mblidhet në Tiranë më 21 dhe 22 shtator]




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.